

V E N D I M
PER HEQJEN E SEKUESTROS PREVENTIVE

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, e përbërë nga:

GJYQTARE : FATIME DEÇOLLI

asistuar nga sekretare gjyqësore **Blerina ORUÇI**, ne prezence te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane, **prokurores Antoneta Sevdari**, sot më **date 26.04.2017**, mori në shqyrtim materialin proçedues që i përket :

KËRKUESE:

F. P., e bija e N., e datelindjes 02.06.19.., lindur ne Shkoder dhe banuese ne Tirane. Perfaqesuar ne gjykim me prokure te posacme me nr.476 rep dhe nr.146 kol dt.05.04.2017 nga av.Arnida Capi me nr.5043 license Dhoma e Avokatise Tirane.

OBJEKTI:

Heqjen e skuestros te llogarive bankare te shtetases F. P. sipas vendimit nr.578 Akti dt.12.03.2017 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

BAZA LIGJORE:

Neni 274/3K.Pr.Penale.

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën ne seance gjyqesore.Degjoi prokurorin qe perfundimisht kerkoi nga gjykata pranimin e kerkeses se paraqitur sipas objektit;

V Ë R E N:

Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane ka rregjistruar procedimin penal nr.1917/2017 per vepren penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale ose te veprimtarise kriminale", te parashikuar nga neni 287 I Kodit Penal.

Ne "TIRANA BANK", rezulton nje llogari bankare ne emer te shtetases F. N. P., e datelindjes 02.06.19.., lindur ne Shkoder dhe banuese ne Tirane, Rr. "Bajram Curri".

Nga informacionet e policise gjyqesore rezulton se kjo shtetase per periudhen Dhjetor 2011-Shkurt 2017 ka nje numer te konsiderueshem transaksionesh bankare, ne shifra te larta, per te cilen krijohen dyshime se vijne nga aktivitete te paligjshme kriminale.

Shtetasja F. P. mban llogari prane bankes "Tirana" qe prej Gushtit 2011 dhe eshte mbajtese e disa mjeteve te identifikuese.

Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane I eshte drejtuar gjykates me kerkese bazuar ne nenet 210, 274 te K.Pr.Penale dhe 36 te K.Penal,meqe ka vleresuar se ekzistojne dyshime te bazuara ne prova se shuma e parave te sipercituara te gjendura ne llogarine e shtetases F. P. ka si burim, veprimtari te paligjshme kriminale dhe krijon dyshime se transaksionet kryhen me qellim per te mbuluar gjurmet dhe per t'i shpetuar sekuestrimtt dhe konfiskimit te ketyre parave si product te vepres penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane,me Vendimin dt.12.03.2017,nr.578 akti ka pranuar kerkesen duke vendosur: **Sekuestrimin e parave te ndodhura ne llogarite bankare te F. N. P. e datelindjes 02.06.19.., lindur ne Shkoder dhe banuese ne Tirane dhe dosjen e sekuestros te llogarive prane Bankes "Tirana Bank", "Banka Kombetare Tregtare", "Raiffeisen Bank" dhe "Alpha".**

Referuar shkreses nr. 3259 Prot. date 13.03.2017, Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, i ka derguar Bankes Tirana, urdher ekzekutimin per Vendimin Penal te mesiperm,nr.578 date 12.03.2017, per sekuestrimin e llogarive bankare te shtetases F. P..

Kerkuesja F. P. i eshte drejtuar me Kerkesen nr. 1212-F Prot. date 23.03.2017 per zhbllokimin e kontove bankare Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, e cila nuk eshte marre ne konsiderate.Kerkuesja pretendon se disponon dokumenta qe vertetojne burimin e te ardhurave, qe vijne si rrjedhoje e aktivitetit privat, biznes i vogel, qe e ushtron ne Hollande ku ajo eshte dhe rezidente.

Per keto arsye ajo I eshte drejtuar gjykates me kerkesen me objektin e mesiperm te gjykimit dhe ka parashtruar se:

Sipas dokumentave te paraqitura si prove para kesaj gjykate, Formularet e deklarimit te te ardhurave per subjektin F.P., Numer (Nipt/Nuis) NL 49...7 BOI per vitet 2013-2014-2015-2016 rezulton se kerkuesja eshte pronare e biznesit te vogel me emer tregtar L... 85, Nipt/NUIS NL4...01, ndermarrje individuale (Biznes i vogel) qe ka nisur aktivitetin nga viti 2013. Sipas deklaratave tatimore nga ushtrimi i ketij aktiviteti prej ketij viti deri ne vitin 2016 rezulton se jane gjeneruar te ardhura te mjaftueshme rreth 150.000 Euro per te justifikuar shumat e derdhura prane llogarive bankare ne emer te znj. F. P..Ne gjykim u vertetua se F. P. ushtron nje aktivitet normal biznesi prej te cilit gjenerojne te ardhura te mjaftueshme qe justifikojne burimin e te ardhurave te ligjshme .

Si burim I te ardhurave te znj. P jane edhe kursime familjare ne vite te realizuara kryesisht nga emigracioni I dy vellezerve te saj dhe i bashkeshortit. Vellezerit L. P dhe N. P,jetojne prej kohesh ne Angli dhe nje pjese te te ardhurave te tyre ja kane dhuruar motres se tyre PF. P.. L. P ka ushtruar pune te ndryshme kryesisht ne te zeze si shume emigrant shqiptar, kurse vellai tjetër N. P eshte i pajisur me pasaporte angleze dhe ushtron i regjistruar aktivitetin si shofer taksie.

Kerkuesja prej viti 2003 ka krijuar familje duke bashkejetuar me shtetasin D. H., me te cilin sipas karteles mjekesore nga spitali Hygea, rezulton se cifti eshte ne asistence mjekesore ne perpjekje per te patur femije. Bashkejetuesi i znj. F. P., z.D. H., ka qene emigrant ne greqi nga viti 1991-1994, ne Itali dhe ne Gjermani, periudhe gjate te ciles ka punuar ne keto shtete duke realizuar te ardhura dhe kursime.

Nga 2007 deri ne vitin 2012 ne shtetin Italian rezulton te kete qene i siguruar, me leje qendrimi, si mekanik makinash ne nje biznes local me nje rroge prej 2.000 Euro ne muaj. Gjithashtu edhe ne shtetin gjerman ka vazhduar veprimtarine e ligjshme ne tregti makinash. Ky shtetas i ka kaluar rreth 40.000 Euro bashkejetueses se tij ne llogarite bankare ne Tirana Bank, shume kjo e cila i shtohet burimit te te ardhurave te ligjshme te zonjes P.

Gjithashtu kerkuesja F. P. ne daten 08.04.2017 ka nenshkruar nje Marreveshje Huaje, duke marre persiper detyrime monetare perkundrejt huadhenesit J.M.. Sipas kesaj marreveshjeje huaje lidhur mes paleve, rezulton se huadhenesi J.M., i ka huazuar huamarresit znj. PF. P. shumen prej 60.000 (gjashtedhjetemije) Euro principal.

Ne nenin 1 te kesaj marreveshjeje parashikohet se: "Principali I huase do te paguhet ne daten 01.05.2017".

Me tej ne nenin 2 percaktohet se:

"Huamarresi (F. P.), paguan per shumen e huazuar nje interes ne masen 0,35%. Interesi do te pershtatet pas kalimit te periudhes prej 1 muaji. Nese huaja nuk eshte paguar ende, pas muajit te pare interesi behet 0,5% ne muaj."

Sipas nenit 3 te kontrates parashikohet se:

"Principali se bashku me interesat mund te kerkohet menjehere nga huadhenesi ne rastet si me poshte:

Falimentimi i huamarresit;

Sekuestro mbi sendet/pronat e huamarresit;

Dhe ne neni 4 te Marreveshjes se Huase parashikohet se: "Data e fundit per kthimin e gjithje vleres eshte 01.06.2017."

Me vendosjen e sekuestros nga ana e prokurorise dhe bllokimit te kontove bankare, kerkuesja F. P. eshte vene ne pozita pamundesie per te shlyer detyrimet e marra persiper nepermjet kesaj Marreveshjeje Huaje, duke u penalizuar nga kushtet e kontrates, sepse nuk ka mundesi te shlyeje detyrimet ne afatet e paracaktuara, si pasoje e bllokimit te llogarive bankare.

Pra me burim te ardhurash te ligjshme, te ardhura te realizuara nga veprimtaria e ligjshme e ketij biznesi, te tjera kursime familjare dhe huaja prej 60.000 Euro e marr ne baze te nje kontrate huaje, znj. F. P. kerkon te bleje nje apartament ne shtetin hollandez ku eshte rezidente, per te cilen ka nenshkruar nje kontrate shitje per apartamentin nr.35962/PK/EL(el/pm).

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, e cila i eshte paraqitur organit te prokurorise znj.P ka marre persiper nje sere detyrimesh si blerese e kesaj kontrate, te cilat konsistojne ne pagesa te ndryshme dhe ne shlyerjen e cmimit te kontrates. Sipas Neni VI "Shkelja e Kontrates" (mospermbushje e Detyrimeve), ne nje rast te tille te mospermbushjes se detyrimeve ateherë parashikohet penalizimi i cili shkon deri ne zgjidhjen e kontrates me ane te nje deklarate dhe kryerja e pageses se gjobes ne shumen e 10 % te cmimit te shitjes (10 % e 165,000 Euro).

Te gjitha keto akte provuese, kerkuesja nepermjet perfaqseses se saj me Prokure I depozitoi ne gjykate, te perkthyer ne gjuhen shqipe, dhe te vertetuara sipas parashikimeve ligjore me vulen "Apostille" te shtetit Holandez. Konkretisht jane aktet:

-Marreveshje Huaje, referuar me siper; Deklarimi total i te ardhurave per tremujor per vitin 2013; Deklarimi total i te ardhurave per tremujor per vitin 2014; Deklarimi total i te ardhurave per tremujor per vitin 2015; Deklarate e Tatimit mbi Vleren e Shtuar sipas 4 tremujoreve per vitin 2016.

Pra duke qene se parate jane nga burime te ligjshme, vertetuar ky fakt me dokumentat e burimeve te ligjshme, dhe nuk jane nga ndonje veprimtari kriminale dhe se nga ana tjeter mbajtja ne sekuestro i shkakton kerkueses F. P. detyrime ekonomike teper te medha, per shkak te kontrates se huase se nenshkruar dhe asaj te shit-blerjes se apartamentit, ku ka marre persiper detyrime ne shkelje te se cilave apo ne vonesa ne pagesa duhet te paguaje kushte penale teper te larta, dhe te rrezikoje deri ne humbjen e investimeve te deritanishme dhe te vete shtepise, kerkuesja F. P. eshte ne dispozicion te organit te hetimit per sqarimin dhe zgjidhjen perfundimtare te ceshtjes.

Per sa me siper, referuar provave te reja, duke qene se kushtet e zbatimit te mases se sekuestros preventive kane ndryshuar, bazuar ne nenin 274 pika 3 te Kodit te Procedures Penale, gjykata duhet te vendose heqjen e sekuestros ndaj llogarive bankare te shtetases F. P. sipas vendimit dt.12.03.2017 te Gjyqates se rrethit Gjyqesor Tirane.

Nga ana e prokurores se ceshtjes u kerkua rrezimi I kerkeses me kete arsyetim:

Parate per te cilat eshte kerkuar te vendoset sekuestro dyshohet se vijne nga veprimtari kriminale. Sot jane paraqitur disa dokumenta nga pala kerkuese por jo ne formen e duhur ligjore por edhe sikur t'i referohesh atyre, ato nuk justifikojne shumen e parave, nuk perputhen me shumen totale por as me deklarimet nder vite pra mosperputhja eshte jo vetem totale por dhe po ta bejme vjetore, perputhja eshte akoma dhe me e madhe.

Nuk flitet per huamarrje 60 mije euro por ne flasim per parate e derdhura ne banke te cilat nuk perputhen me shumen totale dhe eshte e dukshme qe nuk perputhen. Kontrata e huase qe ka depozituar sot pala kerkuese duket e dyshimte dhe fiktive dhe do t'i nenshtrohet procesit te hetimit. Nga personi nen hetim deklarohen te ardhura por jo shpenzimet e jeteses

ne Hollande e cila ka standart te larte jetese.Kerkuesja ka dhene shpjegime para nesh por qendrimi saj ka qene i dyshimte pasi per disa raste ka refuzuar te shpjegoje ne lidhje me ceshtjen.I paraqes sot gjykates si prova :-Proces verbal dt.27.03.2017ku personi nen hetim F. P. ka dhene spjegime.

Analiza ligjore e gjykates.

Ne arsyetimin e saj kjo gjykate iu referua parashikimit ne nenin 274 te K.Pr.Penale I cili parashikon se:

Nenin 274 i Kodit te Procedures Penale:"Objekti i sekuestros preventive" :

“1.Kur ka rrezik qe disponimi i lire i nje sendi qe lidhet me vepren penale mund te rendoje ose te zgjase pasojat e saj ose te lehtesoje kryerjen e veprave penale te tjera, me kerkesen e prokurorit, gjykata kompetente urdheron sekuestrimin e tij me vendim te arsyetuar. 2.Sekuestroja mund te vendoset edhe per sendet, produktet e vepres penale dhe çdo lloj pasurie tjeter qe lejohet te konfiskohet, sipas nenit 36 te Kodit Penal.3.Kur ndryshojne kushtet e zbatimit,gjykata me kerkesen e prokurorit ose te te interesuarit,e heq sekuestron.”.

Patur parasysh sa me lart gjykata cmon se eshte ne kushtet kut masa e sekuestros duhet te hiqet pasi kane ndryshuar kushtet e zbatimit te kesaj mase.

Me ane te akteve provueses te cilat u depozituan ne gjykate ne cilesine e proves shkresore nga ana e kerkueses(jane depozituar edhe ne dosjen perkatese te hetimit penal),vertetohet se kane ndryshuar kushtet e zbatimit te mases se sekustros e vendosur ne llogarite bankare te kerkueses,person nen hetim F. P..Konkretisht behet fjale per aktet shkresore: -Marreveshje Huaje, referuar me siper; Deklarimi total i te ardhurave per tremujor per vitin 2013;Deklarimi total i te ardhurave per tremujor per vitin 2014;Deklarimi total i te ardhurave per tremujor per vitin 2015;Deklarate e Tatimit mbi Vleren e Shtuar sipas 4 tremujoreve per vitin 2016.

Pikerishte per shkak te ekzistences se ketyre rrethana qe u vertetuan me ane te akteve provuese rezulton se ndaj llogarive bankare te F. N. P. prane “Tirana Bank”, “Banka Kombetare Tregtare”, “Raiffeisen Bank” dhe “Alpha” Bak nuk duhet te zbatohet masa e sekuestros konservative.Kjo mase duhet te hiqet nga gjykata referuar parashikimit ne nenin 374/3 te K.Pr.Penale.

Ne keto kushte kjo gjykate e gjen kerkesen e te dyshuares F. P.,te bazuar ne parashikimet e neneve 274/3 te Kodit te Procedures penale e per rrjedhoje e pranon ate rregullisht:

P. K. A.

Gjykata ne baze te nenit 210,274 te K.Pr.Penale

V E N D O S I

- Pranimin e kerkeses.
- 1. Heqjen e skuestros te llogarive bankare te shtetases F. P. sipas vendimit nr.578 Akti dt.12.03.2017 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
- 1. Kundër këtij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane sipas afatit ligjore.

U shpall ne Tirane me dt.26.04.2017.

S E K R E T A R E
BLERINA ORUÇI

G J Y Q T A R E
FATIME DECOLLI